



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2022





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2022



Prishtinë, 2022

Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)
Data e botimit: Tetor/2022)
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së:
<http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), përkatësisht Departamenti i Statistikave Sociale (DSS) ka përgatitur publikimin e radhës për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ekonomi familjare.

Burimi i të dhënave për statistikat e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit janë intervistat nga ekonomitë familjare të caktuara në bazë të mostrës.

Ky publikim përmban të dhëna për përdorimin e teknologjisë informative nga ekonomitë familjare dhe individët, qasjen në internet, përdorimin e internetit sipas grup-moshave dhe gjinisë, përdorimin e E-Qeverisë, përdorimin e E-Tregtisë etj.

Për grumbullimin e të dhënave është shfrytëzuar pyetëtori model nga Eurostati për anketën e TIK-ut në ekonomi familjare.

Mirëpresim komentet, propozimet apo vërejtjet që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së publikimit në të ardhmen në adresën infoask@rks-gov.net

Publikimin përgatitën:

Avni Kastrati – Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,
Naime Rexhepi – Shefe e Divizionit të Statistikave Sociale
Fjolla Shala – Zyrtare e Statistikave të TIK-ut në ekonomi familjare
Hydai Morina – Zyrtar i Statistikave të Standardit Jetësor

Tetor, 2022

Zv. i Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së

Ilir T. Berisha

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
CAPI	Asistencë kompjuterike për grumbullimin e të dhënave
DSS	Departamenti i Statistikave Sociale
TIK	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
%	Përqindje

Përmbajtja

Faqe

1. Qasje në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në Ekonomitë Familjare.....	9
Fig.1.1: Ekonomitë familjare në Kosovë që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa.....	9
Fig.1.2: Grup-moshat që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa.....	10
Fig.1.3. Përdoruesit sipas gjinisë që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa	11
2. Përdorimi i Internetit nga Individët 16-74 Vjeç në vitin 2022	12
Fig. 2.1: Përdorimi i internetit herën e fundit (në shtëpi, në punë ose në ndonjë vend tjetër)	12
Fig. 2.2: Shpeshësia e përdorimit të internetit nga individët në ekonomitë familjare gjatë 3 muajve të fundit.....	13
3. Përdorimi i E-Qeverisë.....	14
Fig. 3.1 Përdorimi i internetit për të kryer aktivitete nëpërmjet një faqe interneti ose aplikacioni të autoriteteve publike ose shërbimeve publike në 12 muajt e fundit.....	14
Fig. 3.2: Përdoruesit e internetit që shkarkuan/printuan ndonjë formular zyrtar nga një faqe interneti ose aplikacion i autoriteteve publike ose shërbimeve publike për qëllime private në 12 muajt e fundit.....	15
4. Përdorimi i E-Tregtisë	16
Fig. 4.1: Blerja ose porositja e mallrave ose shërbimeve përmes internetit për qëllime personale	16
Fig.4.2: Vendet të cilat është bërë blerje ose porositja e mallrave ose shërbimeve përmes internetit për përdorim privat.....	17
5. Interneti i Gjërave.....	18
Fig. 5.1: Personat që përdoren pajisjet ose sistemet të lidhura me internetin për qëllime private në 3 muajt e fundit	18
Fig.5.2: Përdoruesit e TV i lidhur me internet në shtëpinë për qëllime private	19
6. TIK i gjelbërt / qëndrueshëm.....	20
Fig. 6.1: Pajisjet personale elektronike që u zëvendësuan ose nuk u përdorën më	20

Shpjegime_Metodologjike

Anketa mbi përdorimin e TIK në familje zhvillohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës në ekonomitë familjare dhe të gjithë individët e ekonomisë familjare të grup-moshës 16-74 vjeç.

Anketa e TIK mbledh të dhëna për përdorimin e teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në familje dhe individët mbi: pajisjet e përdorura nga ekonomia familjare për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (telefon, pajisje kompjuterike, qasje në internet), përdorimin e internetit, e-blerjeve, e- qeverisjes etj. Për të analizuar më shumë aspekte të përdorimit të teknologjive të reja të cilat janë gjithmonë në zhvillim, pyetësi është dinamik, kështu që çdo vit shtohen module të reja pyetjesh me periudha të ndryshme reference kohore.

Anketa mbi përdorimin e TIK në ekonomi familjare u realizua për herë të parë në vitin 2017 dhe ka vazhduar si anketë e rregullt vjetore. Anketa e TIK në ekonomi familjare zhvillohet sipas metodologjisë së Eurostat-it.


Periudha referuese për mbledhjen e të dhënave është tre dhe dymbëdhjetë muaj përpara intervistës.

Të dhënat janë grumbulluar përmes metodës CAPI (Intervista personale me ndihmën e kompjuterit) duke zhvilluar intervistën e drejtpërdrejt në ekonomi familjare.

Anketa u realizua me një mostër dyfazësh, faza e parë në zgjedhjen e mostrës në rajon dhe faza e dytë mostra në qarqe regjistruese. Ekonomitë familjare janë zgjedhur me metodën e rastit. Madhësia e mostrës ka qenë 3750 familje dhe 3750 individë.


1 Qasje në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në Ekonomitë Familjare

Fig.1.1: Ekonomitë familjare në Kosovë që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa




Nga grafi i mësipërm vërejmë se në vitin 2022 rreth 97.9% të ekonomive familjare kanë pasur qasje në internet nga shtëpia apo banesa

Fig.1.2: Grup-moshat që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa



Nga grafi i mësipërm vërejmë se grup-mosha që ka pasur qasje në internet me përqindje më të lartë është grup mosha 35-44 vjeç me 21,8%.


Fig.1.3. Përdoruesit sipas gjinisë që kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa



Të dhënat nga grafi i mësipërm tregojnë se përdorimi i internetit nga meshkujt dominon me 55.2%, krahasuar me femrat me 43.6%.


2 Përdorimi i Internetit nga Individët 16-74 Vjeç në vitin 2022

Fig. 2.1: Përdorimi i internetit herën e fundit (në shtëpi, në punë ose në ndonjë vend tjetër)



Të dhënat në grafën e mësipërm tregojnë qartë për përdorimin intenziv të internetit ku 90,7% e individëve kanë përdorur internetin gjatë tre muajve të fundit, ndërkohë që 1,1% e individëve janë deklaruar se asnjëherë nuk e kanë përdorur internetin.


Fig. 2.2: Shpeshtësia e përdorimit të internetit nga individët në ekonomitë familjare gjatë 3 muajve të fundit



Prej 90.7% e individëve të cilët kanë përdorur internetin gjatë tre muajve të fundit, 83 % kanë përdorur internetin disa herë gjatë ditës ndërsa 0,6% e kanë përdorur më pak se një herë në javë.


3 Përdorimi i E-Qeverisë

Fig. 3.1 Përdorimi i internetit për të kryer aktivitete nëpërmjet një faqe interneti ose aplikacioni të autoriteteve publike ose shërbimeve publike në 12 muajt e fundit



Nga grafi i mësipërm vërejmë se 72% e personave që e përdorën internetin gjatë 12 muajve të fundit nuk e kanë përdorur internetin për të kryer shërbime nëpërmjet një faqe interneti ose aplikacioni të autoriteteve publike ose shërbimeve publike, ndërsa 13,9% e përdorën për të marrë informacione lidhur me shërbimet, ligjet dhe orarët e punës, 10,8 % e përdorën për tu lidhur me shërbimet publike sikurse është shëndeti etj. dhe 3,3% për tu qasur në bazat e të dhënave ose regjistra publik.


Fig. 3.2: Përdoruesit e internetit që shkarkuan/printuan ndonjë formular zyrtar nga një faqe interneti ose aplikacion i autoriteteve publike ose shërbimeve publike për qëllime private në 12 muajt e fundit



Nga të dhënat në grafën e mësipërm vërejmë se prej 96,6 % e personave që e përdoren internetin gjatë 12 muajve të fundit, rreth 18,5% deklarojnë se kanë shkarkuar ose printuar ndonjë formular zyrtar, ndërsa 78,1% e tyre nuk kanë kryer ndonjë nga këto aktivitete.


4 Përdorimi i E-Tregtisë

Fig. 4.1: Blerja ose porositja e mallrave ose shërbimeve përmes internetit për qëllime personale



Të dhënat në grafën e mësipërm tregojnë se në vitin 2022 përqindja e individëve që kanë blerë apo porositur mallra dhe shërbime përmes internetit gjatë 3 muajve të fundit ishte 51% ndërsa rreth 28,4% asnjëherë nuk kanë blerë ose porositur online.


Fig. 4.2: Vendet të cilat është bërë blerje ose porositja e mallrave ose shërbimeve përmes internetit për përdorim privat



Të dhënat në grafën e mësipërm tregojnë blerja ose porositja e mallrave dhe shërbimeve përmes internetit për përdorim privat gjatë 12 muajve të fundit në Kosovë ishte 49,9%.


5. Interneti i Gjërave

Fig. 5.1: Personat që përdoren pajisjet ose sistemet të lidhura me internetin për qëllime private në 3 muajt e fundit



Në grafën e mësipërm vërejmë se prej 90,7% e personave që përdoren internetin gjatë 3 muajve të fundit rreth 84,5% e tyre nuk kanë përdorur asnjë nga pajisjet e lidhura me internet, ndërsa 3,7% e tyre kanë përdorur fshesë robotike, frigorifer, makina të kafesë të lidhura me internet.


Fig.5.2: Përdoruesit e TV i lidhur me internet në shtëpinë për qëllime private



Prej 90,7% e personave që përdorin internetin gjatë 3 muajve të fundit, rreth 79.3%e tyre deklaruan se kanë TV te lidhur me internet.

6. TIK i gjelbërt/qëndrueshëm

Fig. 6.1: Pajisjet personale elektronike që u zëvendësuan ose nuk u përdorën më



Nga të dhënat në grafën më lartë vërejmë se pajisjet elektronike siç janë kompjuteri desktop, laptopi ose tableti dhe celulari ose smart phone ne të shumtën e rasteve nuk janë zëvendësuar mirëpo janë mbajtur ende në shtëpi. Kurse 9.8% e përdoruesve të kompjuterit desktop janë deklaruar se e kanë shitur ose e kanë falë, 10,5% për laptop ose tablet dhe 15,3% për celularin ose smart phone etj.

Agjencia e Statistikave te Kosovës: Përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë *strukture organizative*: **Departamentet prodhuese**; *Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse**; *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale**; Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj.

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41 Agjencioni ka këtë *strukture kualifikuese*, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve të rajonit.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Rr. "Zenei Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Kryeshefi Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>